



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 638/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkritazi për apelin e subjektit politik KDTP me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të PZAP-it A nr. 416/2010 të datës 12.12.2010, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**REUZOHET** si i pabazuar apeli i subjektit politik KDTP, për rishqyrtimin e vendimit të PZAP-t, A nr. 416/2010 të datës 12.12.2010.

## A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një apel më datë 15.12.2010, nga subjekti politik KDTP, ne te cilën pretendohet se vendimi i PZAP-it A nr. 416/2010 datë 12.12.2010, është i pabazuar, jokorrekt dhe diskriminues për shkak se “KDTP posedon një marrëveshje me pronarin e pronës dhe para se PZAP te vendos njëanshëm është i detyruar që të kërkoj kopje të kontratës me pronarin e pronës Sedat Begoli në rrugën “Bajram Kelmendi” Prishtine, dhe në qoftë se kjo i është dashur PZAP-it si dëshmi, KDTP ka qene e gatshme që ta dërgoj”. Parashtruesi i apelit thekson se duhet marre parasysh e kaluara e këtij subjekti politik dhe të dhënat të cilat tregojnë që KDTP nuk ka pasur asnjëherë ankesa të këtij lloji.

Parashtruesi i apelit nuk ka prezantuar asnjë fakt të ri, porse ka bashkangjitur kopje te: kërkesë për përgjigjeje nga PZAP dt, 11.12.2010; ankesës se subjektit politik Aleanca për Kosove te Re (AKR) paraqitur kundrejt subjektit politik KDTP dt, 10.12.2010, se bashku me foto te marra nga vendi i ngjarjes ku tregohet se posterat KDTP janë vendosur ne rrugën “Bajram Kelmendi”; vendimi A416 dt, 12.12.2010, si dhe letrën përcjellëse te këtij vendimi prej PZAP për subjektin politik KDTP; vendimi A400 dt, 12.12.2010, ne lidhje me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) paraqitur kundër KDTP së bashku me letrën përcjellëse të këtij vendimi prej PZAP për KDTP.

Vendim i PZAP-it A nr. 416 të datës 12.12.2010, është marrë në bazë të dispozitave ligjore të Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:*

*a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;*

**Neni 118 paragrafi 4 i LZP-së parasheh:**

*118.4 Mund të apelohet vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuara.*

PZAP pasi shqyrtoj shkresat e lendes arsyetohet si me poshtë:

**- apeli të refuzohet si i pabazuar**

PZAP thekson se në pajtim të nenit 4.3 të Rregullores së Punës së Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe përpara se të merrej vendimi në lidhje me ankesën me numër lende A416, parashtruesit të apelit (KDTP) i është dhënë mundësia për tu përgjigjur brenda një kohe të arsyeshme. Subjekti politik KDTP në përgjigjen e tij me dt, 11.12.2010, ka pohuar se “posterat e këtij subjekti politik janë vendosur në rrugën “Bajram Kelmendi” Prishtinë, për arsye se midis KDTP dhe Sedat Begolit, pronarit të objektit në rrugën “Bajram Kelmendi” në të cilën janë vendosur posterat e KDTP-se ekziston një marrëveshje për shfrytëzimin e kësaj prone”. Sipas vlerësimit të PZAP, përgjigjja e parashtruesit ka qene sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, pasi që në momentin kur KDTP pretendon se posedon një marrëveshje të shfrytëzimit të pronës në fjalë, është e detyruar që nëpërmjet provave të vërtetojë faktin e pretenduar, çka nënkupton se në përgjigje duhet të ishte bashkangjitur kopja e kontratës e që në rastin konkret nuk ka ndodhur diçka e tillë. Ashtu siç është cekur me lartë ankesa me numër A416 ka të bëjë me mbulim posterash dhe duke marrë në konsideratë provat e paraqitura nga parashtruesi i kësaj ankesë AKR (foto të cilat tregojnë qarte se posterat e kandidatës së KDTP me nr.40 kanë mbuluar posterat e kandidatit të AKR) si dhe faktin që subjekti politik KDTP nuk e ka justifikuar nëpërmjet fakteve këtë veprim, PZAP vendosi në përputhje me nenin 33 (a) të LPZ-se, që të shqyrtoj për KDTP gjohet me vlerë 1550 (njemijepesqindpesdhjete) euro. Gjithashtu pretendimet nga parashtruesi i apelit, se vendimi i PZAP A nr. 416 i datës 12.12.2010 është i pabazuar, diskriminues dhe jokorrekt dhe se subjekti politik KDTP posedon kontratën e shfrytëzimit me pronarin e objektit, nuk ofrojnë asnjë fakt të ri, që do të ndikonte në ndryshim të vendimit A416. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e lartcekura e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 638/2010 më datën 23.12.2010.

